**Data 21.12.2023**

**<u>PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË</u>**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**
*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROKURIMIT**:

“Rikonstruksion shkolla “Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare "Demokracia”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (**CPV**):

Kodi CPV: Kodi CPV: 45214220-8 - Punime ndërtimi për shkolla 8-9 vjeçare

VLERA E FONDIT LIMIT: 47.500.000 (dyzet e shtatë milion e peseqind mijë) lek, pa TVSH.

<u>Afati i realizimit të punimeve është 105 dite</u>

<u>Garancia per mbulimin te difekteve ,që mund te lindin gjatë shfrytëzimit të objektit , nga ana e firmës të jetë 2 vjet .</u>

Argumentim:

MBI PËRGATITJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE PËRLLOGARITJEN E VLERËS LIMIT TË KONTRATËS

Në zbatim të urdhërit të grupit te Specifikimeve 279 Datë 15.09.2023 Titullarit të Autoritetit Kontraktor, “Mbi Përgatitjen e Specifikimeve Teknike dhe Përllogaritjen e Vlerës Limit per objektin e mësipërm, të planifikuar për tu kryer në programet e investimeve.

Grupi i specifikimeve teknike, pasi u njoh me objektin e prokurimit:

1. Dokumenteve sipas Vendimit te Keshillit Bashkiak nr.150 datw 22.12.2022 “Pwr miratimin e programit buxhetor afatmeswm 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit tw bashkisw Durrws pwr vitin 2023”.

2. Shqyrtoi dokumentat e mësipërme dhe programoi punën për grumbullimin e informacionit, lidhur me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike të punimeve, te hartuar nga: Grupi i Specifikimeve Teknike pjesë e Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike.

**PËRCAKTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE** :

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, grupi i punës u mbështet në:
Specifikimet teknike të hartuar nga grupi i Specifikimeve Teknike pjesë e Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike., objekt i këtij prokurimi.
*Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë në përputhje të plotë me kërkesat*
*e Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*

## PËRLLOGARITJA E VLERËS LIMIT TE KONTRATËS

Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, Mbështetur në Ligjin nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 neni 76 ,sipas të cilit:

1. Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

**a)** çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe

**b)**studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe

**c)** çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

**ç)** çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t´i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

**Në përfundim të punes se grupit u vërejt se:**

**Grupi i punës u bazua në:  projektin dhe preventivin, për projekt zbatimin e objektit:**

**"RIKONSTRUKSION  SHKOLLA 9 VJECARE "DEMOKRACIA" "**

Pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe informacionit të mbledhur të zërave te punimeve bazuar në një metodologji të paracaktuar, rezultoi se: Vlera e përgjithshme e kontratës për prokurimin me titull.

**“RIKONSTRUKSION SHKOLLA 9 VJECARE "DEMOKRACIA" ”**

rezultoi të jetë: **47,500,000 (dyzet e shtatë milion e pesëqind)** lek pa TVSH

Mbështetur në rezultatin e sipër nxjerë, komisioni me unanimitet

**V E N D O S I :**

Të përcaktojë Vlerën Limit të Kontratës; Për një shumë prej **47,500,000 (dyzet e shtatë milion e pesëqind ) lek pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:
Sipas specifikimeve bashkangjitur të hartuara, vendosur dhe perllogaritur nga struktura të posacme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punes për hartimin e specifikimeve teknike dhe perllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3*
*b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8*

**Argumentimi**: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

**Argumentimi**: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”si dhe nenit

(Shënim: *përcaktoni* ***nëse është rasti****, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkese specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit* apo nevojën që *operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës).*

### 1.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020**,** 2021 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 47’000’000 lekë.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

*Kerkesa e mesiperme eshte bazuar ne vleren e fondit limit te kesaj procedure,si dhe mbeshtetet ne në nenin 77, pika 3, e LPP, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,neni 43,b*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne Ligjin 9920 date 19.05.2008, Per Procedurat Tatimore ,neni 64 Deklarata Tatimore*

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020, 2021 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ne perputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar, i

ndryshuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit..

(*Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij.

Kërkesa për paraqitjen e bilnaceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2022 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2022.

*Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

*Kjo kerkese bazohet ne Ligjin nr.9632,date 30.10.2006 ,Per sistemin e taksave vendore i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve te miratuara te kryerjes se pagesave te percaktuara nga cdo njesi e qeverisjes vendore*

**2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 23'000'000 Lekë, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 92’000’000 lekë.
Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

*Vërtetime të lëshuara nga një autoritet/ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. të shoqëruara me formular vlerësimi sipas shtojcës 9.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, kërkohet: ‚Vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.*

***Argumentimi****:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar fondit limit sipas nenin 39, pika 5 ”Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

---

**Aftësitë teknike dhe profesionale te tjerat si me poshtë jan**ë hartuar, vendosur dhe perllogaritur nga struktura të posacme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punes për hartimin e specifikimeve teknike dhe perllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë , e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- NP–1A Punime gërmimi në tokë.
- N.S – 1A Punime për prishjen e ndërtimeve.
- NP–2A Ndertime Civile dhe industrial.
- NS-4B Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.
- NS-2A Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre.

- NS–12A Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit.

- N.S–14 A Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.
- NS–18 A Punime topogjeodezike.

.

***Argumentimi**:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe Vendim nr.42, datë 16.1.2008 "Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar.

**Kategoritë e poshtëshënuara, janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve,**

| KATEGORIA E KËRKUAR | PERSHKRIMI I KATEGORISË SIPAS LEGJISLACIONIT TË FUSHËS | ZËRAT E PUNIMEVE QË PARASHIKOHEN TË KRYHEN NË PREVENTIV, QË PËRFSHIHEN NË KATEGORINË PËRKATËSE | NIVELI I KLASIFIKIMIT I KËRKUAR PËR KATEGORINË RESPEKTIVE | |
|---|---|---|---|---|
| N.S – 1 A | Punime për prishjen e ndërtimeve. | -Prishje shtrese pllakash<br>-Cmontim - heqje dyer te brendshme<br>-Cmontim - heqje dritare<br>-Transport i paisjeve shkollore (banka) me auto deri 5 km<br>-Prishje suvatim | A, 0-20 milionë lekë | 1,081,660 |
| NP–1 A | Punime gërmimi në tokë. | -Germim dheu me krah e transport me k dore 10 m, kategoria III<br>Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km | A, 0-20 milionë lekë | 78,480 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| NP–2 B | Ndertime Civile dhe industriale | -Konstruksione metalike te thjeshta rrethim fushe+koshat e basketbollit.<br>-Struktura monolite betoni C 20/25(betone me ngjyre).<br>-F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm.<br>-Mur me blloqe betoni t=20cm deri 3m me llaç perzier M 15,Hm=1.5 m.<br>-F.V zgara dekorativa hekuri me figuracion mesatare H=1m + PORTA<br>-F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm<br>-F V hekur betoni periodik Ø > 10 mm<br>-Pllake themeli, trare e bazamente b/a C 20/25(Muri i Jashtem Rrethues).<br>-Nenshtrese zhavori<br>-Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka vetshtrenguese<br>-Bordura betoni 6x20 cm<br>-Shtrese stabilizanti t=5cm<br>- Shtrese rere per tubat dhe nivelime<br>-FV gjeotekstil 165g/m2<br>-Ndertim drenazhi, mbushje me gure lumi.<br>-Mur me blloqe betoni t=20cm deri 3m me llaç perzier M 15,Hm=1.5 m.<br>-F.V zgara dekorativa hekuri me figuracion mesatare H=1m + PORTA<br>-F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm<br>-F V hekur betoni periodik Ø > 10 mm<br>-Pllake themeli, trare e bazamente b/a C 20/25(Muri i Jashtem Rrethues) | A, 0-20 milionë lekë | 13,858,949 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| NS-4 B | Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese. | -Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 15 cm. Bikomponente (paste).<br><br>-Boje hidroplastike importi cilesi e I-re brendeshme+fasade.<br><br>-Boje vaji siperfaqe metalike.<br><br>-Veshje fasade me polisterol kompakt jeshil t=5cm + rrjete + suva.<br><br>-Veshje me pllake majolike per tualetet.<br><br>-Suva brenda mur tulle h~4m me pompe, llaç perzier M 25.<br><br>-Tavan me kartonxhes.<br><br>-Patinim muri rere fino.<br><br>-Suva e zakonshme fasade h ~ 8 m (Muri i Jashtem Rrethues).<br><br>-Mbjellje peme dekorative Bli (16-18) cm.<br><br>-F.v fidan peme decorative.<br><br>-F.v Shkurre dekorative juviperus V18 grup 3.<br><br>-F.v fidan lule decorative. | B, 21-50 milionë lekë | 21,591,621 |
| NS-2A | Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre. | -Furnizim instalim tub xingato DN-2" (57x3mm)<br>-Pjese speciale çel Ø~200<br>-F.V hidrante Ø 80 mm fikes zjarri me shkume ne koridore+ambjent teknik<br>-F.V hidrante Ø 100 mm DN-2" komplet me kaseten dhe tubin e gomes dhe kaseten. | A, 0-20 milionë lekë | 4,878,437 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | -F.V Buton alarmi<br>-F.V Tabela drejtim dalje<br>-F.V Kaset + hidrant zjarri i brendshëm. Kasetë brenda murit, llamarine çeliku e emaluar me ngjyrë të kuqe RAL 3000 - UNI 9227, me baze rezine. Dimens.(370-390x590-610x180-<br>190) mm, tub fleksibël 30 m, Aksesorët: saraqineske ndërprerëse 1½"", lançë + zorre uji DN 45. Pjesa e përparme e mbyllur me çelës."<br>-F.V Grupi i lidhjes me motopompen për hidrant DN 65. Vendosja në kasetë të jashtme, llamarine çeliku të emaluar ne ngjyre, te kuqe RAL 3000, valvol sigurie dhe moskthimi 2""<br>(DN 50) materiali i grupit bronz."<br>-F.V Pompa e mbrojtjes kunder zjarrit (P/HZ) Moto pompe dizel, Prurja: 18 m³ / h,<br>Prevalenca: 56.7 mkH2O, Fuqia motorike 5.5 kW, Lidhjet: Ø 21/2"", PN 16; Pompe elektrike, Prurja: 18 m³ / h, Prevalenca: 56.7 mkH2O, Fuqia e instaluar: 5.5 kW, 3F/400V/50Hz, Lidhjet: Ø 2½"", PN 16; Pompe Jockey elektrike, Prurja: 3 m³ / h, Prevalenca: 58 mkH2O, Fuqia e instaluar: 1.1 kW, 1F/230V/50Hz, Lidhjet: Ø 1 1/4"", PN 16"<br>"F.V WC allafrenga importi shkolla + dhoma e ndrimit fushat e tenisi"<br>"F.V lavaman porcelani importi me mishelator shkolla + dhoma e ndrimit fushat e tenisit"<br>F.V pilete dyshemeje Ø 30 mm<br>"F V bolier 80 liter, uje te ngrohte shkolla + dhoma e ndrimit fushat e tenisit"<br>FV. Tuba e rakorderi PVC<br>F.V Kolektor shpendares 1" ( 6+6 ) | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | F.V Kolektor shpendares 3/4" ( 4+4 )<br>F.V Kolektor shpendares 3/4" ( 5+5 )<br>F.V Tubo PE -Xa, DN 15 (Ø20 X 2.8) mm<br>F.V Tubo PE -Xa, DN 12 (Ø16 X 2.2) mm<br>"Grup pompe 3kw me prurje maksimale 120lt/minut,Presion maksimal 5.2bar"<br>-Pusete shkarkimi b/a, 80 x 80 cm, h = 100 cm cdo kat puseten perkatese.<br>-Pusete b/a shiu 40 x 40 cm, h = 100 cm, me kapak zgare hekuri KUB.<br>-F V tub drenazhi Ø 150 mm<br>-Tub kanalizimi pvc Ø 200 mm<br>-Ulluk shkarkimi vertikal me baker Ø 120<br>-Kasete shkarkimi me llamarine bakri 1.0mm | | |
| N.S -12A | Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit | -F.V Tubo çeliku pategel ( Mannesmann ose ekuivalent ) Ø 1¼"<br>-F.V Tubo çeliku pategel ( Mannesmann ose ekuivalent ) Ø 1'<br>-F.V Tubo çeliku pategel ( Mannesmann ose ekuivalent ) Ø 3/<br>-F.V Kolektor shpendares 1" ( 6+6 )<br>-F.V Kolektor shpendares 3/4" ( 4+4<br>-Termoizolim tubi Ø 3/4" me armofleks ose ekuivalent (d28x9)<br>-Termoizolim tubi Ø 11/4" me armofleks ose ekuivalent (d42x9)<br>-Termoizolim tubi Ø 11/2" me armofleks ose ekuivalent (d54x9)<br>-Termoizolim tubi Ø 21/2" me armofleks ose ekuivalent (d76x9)<br>-F.V tuba bakri e rakorderi d = 15x1 mm<br>-F.V tub te zeze DN 65 [2 1/2"] dhe rakorderi<br>-F.V tub te zeze DN 40 1 1/2"] dhe | A, 0-20 milionë lekë | 3,644,319 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | rakorderi<br>-F.V tub te zeze DN 32 1 1/4"] dhe rakorderi<br>-F.V element radiatori me llamarine 600x200 mm 1,5 kw<br>-F.V. Kanal I tymrave me llamarine çeliku, me shtrese izioluese 220/270 mm .<br>-F.V Kaldaje çeliku (grup termik), lenda e djegeshme ashkla druri (pellets)<br>- Kapaciteti Q=350 kW<br>- lidhjet DN80<br>- dalja e oxhakut Øe250 mm.<br>Me pompe antikondense te inkorporuar, e pajisur me te gjithe komponentet e sigurise dhe kontrollit si dhe aksesoret e nevojshem."<br>-F.V Pompe qarkullimi binjake e terminaleve INVERTER<br>- prurja 13.3 $m^3$/h;<br>- prevalenca 100 kPa;<br>- lidhjet DN 65, Pn 6;<br>- fuqia elektrike 2x1.5 kW, rryma 2x5.4 A;<br>- ushqimi 1F/230V/50Hz."<br>-F.V Ene zgjerimi me diafragme per linjat e terminaleve ngrohes egzistues<br>Volumi 200lit Diametri 600 mm<br>Lartesia 812 mm<br>P.max 6 bar T.punes -10÷99°C<br>Lidhja Ø3/4"""<br>-F.V Ena e zgjerimit te terminaleve eshte: Kapaciteti: jo me e vogel se 35 litra:- Dimensionet jo me e vogel se 404 mm -Lartesia 408 mm:-Presioni max 6 bar:-Temperatura e sistemit -10° C deri ne +90° C: Lidhja ne %" | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| NS–14 A | Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV | -F.V Kasete plastike KE me 12 modular (vende)<br>-F.V Kasete plastike KE me 36 modular (vende)<br>-Panel I matjes se energjise 1/3 fazor, 10 poste<br>-Automat termo-elektro magnetik,4P;380V;100A<br>-Automat magneto-termik 380V,25A 4P<br>-Automat magneto-termik 380V,63A 4P<br>-Automat termo-elektro magnetik,4P;380V;40A<br>-F.V. automat termo.manjetik diferencial 1f220v,32Adl=0,03A<br>-F.V. automat termo.manjetik diferencial 2p220v,20Adl=0,03A<br>-F.V. automat termo.manjetik diferencial 2p220v,16Adl=0,03A<br>-F.V. Llampa sinjalizimi 220v 1,2w<br>-F.V. kuti shperndarese PT7,PT8, PT11<br>-F.V percjelles PV-500 Ø 1 mm2 per sirene e brendeshme<br>-F.V percjelles PV-500 Ø 1.5 mm2<br>-F.V percjelles PV-500 Ø 2.5 mm2<br>-F.V percjelles PV-500 Ø 4 mm2<br>-F.V percjelles PV-500 Ø 10 mm2<br>-F.V percjelles PV-500 Ø 6 mm2<br>-F.V.ne toke kabllo Cu fuqie ÷1000V me izolim gome e mbulese plastmasi, te armuar, 4x25mm2<br>-Kabell interneti cad 6<br>-F.V. Percjelles CU per tokezim d=25mm2 I zhveshur<br>-Tub shllang Ø 32-36mm<br>-Tub shllang Ø 14-17mm<br>-Tub shllang Ø 22-26mm<br>-Çelsa nje polar 10A 280V komplet<br>-F.V kuti suport pllaket 2 modular<br>-F.V priza shuko jashte murit 2P+T IP=54<br>-Priza shuko universale Komplet<br>-F.V priza bivalente 220V 10A 2P-T<br>-FV Priza trefazore me tokezim 25A | A, 0-20 milionë lekë | 2,366,533 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | 280V komplet<br>-Priza  per internet komlet<br>-Ndricues Katror LED 50w , 4000-6000K,3200lm, 600*600mm<br>-Ndricues katror LED me 18w , 4000K,1800lm,<br>-F.V Ndricues mural per ambientet e shkallve<br>-16 Port Rackmount Switch profesional<br>-FVSirene e brendeshme audio vizive<br>-FV Sirene e jashteme<br>-Ndricues projektor  100 wat per ambiente te jashtme  te shkolles<br>-FV ndricues evakuimi 1x11wIP40<br>-FV Fiber Optike, 8 core, Multi Mode per instalim.<br>-Shirit tok hekuri zingato 30x3 mm , zbritje<br>-Maja rrufepritesezingato Dn-16mm,L0,5m<br>-Elektroda tokezimi  komplet 2´´<br>-Puseta kontrolli 40x40x40 per matje te tokezimit<br>-Fiksues te konturit ne parapet<br>-Fiksues te shkarkueses ne fasade | | |
| NS-18 A | Punime topogjeodezike | | A, 0-20 milionë lekë | Perfshire zerat specifik |

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Topograf/Gjeodet 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Mekanik 1 (një)

*Për stafin e sipërcituar të disponoje dokumentacion që vërteton profesionin si: diploma e inxhinierëve dhe kontrata pune.*

*Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes se Formularit permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8 ne DST.*

2.3.4. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- Ekspert Zjarrfikës — 1 punonjës
- Auditues Energjitik i Certifikuar
  me titull: Auditues Energjitik ne Ndertesa — 1 punonjës

*Për stafin e sipërcituar të disponoje dokumentacion që vërteton profesionin si: diploma e inxhinierëve, dëshmi profesionale të punonjësve(teknikut) ose ekuivalenti i tij/saj dhe kontrata pune.*
*Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes se Formularit permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8 ne DST.*

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- Teknik ndertimi — 1 punonjës
- Murator — 2 punonjës
- Bojaxhi — 4 punonjes
- Elektricist — 2 punonjës
- Hidroizolues — 1 punonjës
- Hidraulik — 2 punonjës
- Pllakashtrues — 4 punonjës
- Drejtues mjeti — 2 punonjës
- Saldator — 1 punonjës
- Punonjes karpentier — 1 punonjës
- Punonjes hekurkthyes — 1 punonjës
- Punonjes per punime gipsi — 2 punonjës
- Punonjes suvaxhi — 4 punonjës
- Punëtore ndertimi te thjeshte — 21 punonjës

*Për stafin e sipërcituar të disponoje dokumentacion që vërteton profesionin si: dëshmi profesionale të punonjësve ose ekuivalenti i tij/saj dhe kontrata pune.*
*Ndërsa për punëtori të thjeshtë, të disponoje një vetëdeklarim nga shoqëria, ku listohen si punëtorë të thjeshtë*
*Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes se Formularit permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8 ne DST.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të

dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

**Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.**

- **Inxhinieri i Ndertimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të projektit për secilin nga zërat e punimeve për ndërtimin e objektit, zbërthimin e projektit zbatimit, punimet e betonit të hekurit, punimet e muraturës, shtresave të dyshemesë. Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve si psh të betonit, hekurit etj.
- **Inxhinieri Elektrik** është i nevojshëm për për zbatimin e saktë të projektit elektrik,zbërthimin e projektit , për sistemin e instalimeve elektrike si dhe të ndriçimit.
- **Inxhinier Mekanik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të projektit mekanik, për realizmin e sistemit të ngrohje, për pajisjet dhe makineritë e ndryshme.
- **Inxhinier Hidroteknik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të projektit hidrik, për realizmin e sistemit të furnizimit me ujë dhe KUB.
- **Inxhinier Topograf** është përgjegjës për azhornimin, piketimi,kuotim e punimeve ne kete objekt..
- **Teknik Ndërtimi** është përgjegjës për organizimin e punes ne kantier.
- **Drejtues Mjeti** janë të nevojshëm për drejtimin e mjeteve si kamion, autobetoniere, autobot uji,manovrator,vinc.
- **Hidrauliku** është i nevojshëm për punimet hidrosanitare, dhe realizmin e instalimeve të ujit e të kanalizimieve ne baze të zërave te preventivit duke ndjekur me përpikmëri kushtet teknike te zbatimit si dhe është përgjegjës për koordinimin e punës.
- **Elektriçisti** është i nevojshëm për punimet elektrike dhe realizmin e instalimeve elektrike ne baze të zërave te preventivit duke ndjekur me përpikmëri kushtet teknike te zbatimit.
- **Hidroizolues** shërben për realizimin e hidroizolimin e dyshemeve dhe të tarracës sipas zërave të preventivit dhe projekti të zbatimit.
- **Muratorët** shërbejnë realizimin e zërave të muraturës, ndërtimin e mureve.
- **Bojaxhi** shërbejnë për realizimin e zërva të lyerjes së mureve, lyerjen e fasadav.
- **Pllakashtrues** shërbejnë për shtrimet e dyshemeve me pllaka si dhe veshjen e tualeteve me pllaka majolike.
- **Saldator** shërbejnë realizimin e struktures metalike.
- **Karpentieri** shërbejnë të vendosin armaturen dhe të realizojnë elementet prej betony të armuar.
- **Hekurkthyesi** shërben për të vendosur celikun në elementët prej betoni të armuar sipas formës së kërkuar.
- **Suvaxhiu** shërben për të suvatuar muret e tullës.
- **Punonjes per punime gipsi** shërben për të realizuar punimet e tavanit, e cila do të realizohet me kartonxhes.
- **Ekspert Zjarrfikës** shërben për të realizuar dhe zbërthyer projektin e mbrojtjes ndaj zjarrit dhe skemën e evakumit në objekt duke qenë se objekti në fjalë klasifikohet i rëndësisë së lartë.
- **Auditues Energjitik i Certifikuar me titull: Auditues Energjitik ne Ndertesa** shërben për të analizuar dhe realizuar me përpikmërinë më të lartë të punimeve elektrike, izolim termik.Inspekton sistemet e ngrohjes, përcakton karakteristikat teknike të veshjes së jashtme me polisterol, inspekton sistemet e ndricimit dhe të ngrohjes së ujit.

2.3.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht __55___ persona** .
(Numri prej 55 personash përfshin **21** punëtorë të thjeshtë të cilët janë llogaritur analitikisht në grafikun e punimeve duke përdorur orët e punës sipas manualit të ndërtimit dhe volumet totale për secilin zë punimesh në preventiv për kohën kur shënohet piku i punimeve , + **34 persona** janë stafi i kualifikuar i inxhinierëve, teknikëve dhe staf teknik specialistësh për kryerjen e punimeve .
Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

*2.3.6.* Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

| **Lloji Makinerive** | **SASIA** |
|---|---|
| Kamiona vetshkarkues kapaciteti mbajtes minimalisht deri ne 10 ton . | 1 copë |
| Kamioncin me kapacitet mbajtes 3.5-5 Ton. | 1 copë |
| Kamioncine me kapacitet mbajtes jo me shume se 1 ton. | 1 copë |
| Skela | 1000 m2 |
| Nivelues per shtresa betoni | 1 copë |
| Matrapik per prishje e ndertimeve | 2 Copë |
| Fadrome | 1 Copë |
| Autovinc | 1 Copë |
| Minieskavator | 1 Copë |
| Betoniere / vellimi 1 m3 | 2 Copë |
| Autobetoniere | 2 Copë |
| Autobot Uji | 1 Copë |

*Për mjetet dhe pajisjet e sipërcituar të disponojë: Dëshmi, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion sipas Kodit Rrugor operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës të shoqëruar me dokumentat si: Leja e qarkullimit, Çertifikata e Kontrollit Teknik, Çertifikata e Transportit të mallrave/Liçenca, Foto e mjetit (Për mjetet dhe pajisjet e tjera që nuk janë të shënuara në rregjistra publike duhet të disponojë dokumenta që vërtetojnë pronësinë/qiranë dhe libreza/te dhena teknike, ose ekuivalenti i tij/saj)*
*Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes se Formularit permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8 ne DST*

**Argumetimi:**

**Mjetet e mësipërme kërkohen: Duke u bazuar në proceset e punës, volumet e germimit që do të realizohen javën e parë duke llogaritur që automjetet vetëshkarkuese të bëjnë 10-12 rrugë në ditë. punimeve të preventivit dhe certifikatën e kontrollit teknik të mjeteve rrugore.**

***Argumentimi:*** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021"Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas Vendimit nr. 629, datë 15.7.2015, "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre (ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018) dhe Udhëzimit nr.2, datë 08.05.2003, "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit".

**2.3.8** Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata

Certifikat: ISO 9001 -Sistemi i Menaxhimit të cilesisë, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Argumentimi:**

Kjo çertifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi , e cila mundeson

implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

- Certifikat: ISO 18001/45001 - Sistemi i manaxhimit te sigurise dhe shendetit ne vendet e punes, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Sistemi i manaxhimit te sigurise se trafikut rrugor ISO 39001

  Kjo çertifikatë mundëson që kompanite te punojne me sistemet e qarkullimit rrugor, te reduktojne dhe te perjashtojne rreziqet e humbjes te jetes dhe plagosjeve ne lidhje me aksidentet gjate procesit te punes.

**Argumentimi:**

Sistemi i manaxhimit te sigurise dhe shendetit ne vendet e punes mundeson qe çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve

## 2.3. 9 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

### Kriteret për shpalljen e ofertës fituese

Bazuar në pikën 3, neni 45 Seksioni III VKM 285, datë 19.5.2021 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK "Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet **në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave"**

Specifikime teknike, projekti, preventivi, grafiku dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT, me të dhenat e meposhteme:

### 1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

| | |
|---|---|
| Emri | Bashkia Durrës |
| Adresa | Sheshi "Liria", Qyteti Durrës |
| Tel/Faks | 052 22 23 10 |

E-mail info@durres.gov.al
Ueb-faqe www.durres.gov.al

**2. Lloji i procedurës së prokurimit:** Procedurë e Hapur Punë

**3. Numri i referencës së procedurës /Lotit:** REF-91817-12-21-2023

**4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër:** " Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare "Demokracia"

**5. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):** Kodi CPV: 45214220-8

- Punime ndërtimi për shkolla 8-9 vjeçare

**6. Fondi limit**: 47.500.000 (dyzet e shtatë milion e peseqind mijë) lekë pa TVSH

**7. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 105** (ditë)

**8. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave**: 08.01.2024 Ora 10.00

Dokumentat e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit te gjithe anetaret e njesise kane akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP(www.app.gov.al).

**Njësia e Prokurimit**